



# Procesi i kalimit në transmetime dixhitale



# **Procesi i kalimit në transmetime dixhitale**



*Tiranë 2015*

## ***Procesi i kalimit në transmetime dixhitale***

*Botues:*



**Albanian Media Institute  
Instituti Shqiptar i Medias**

Rr. Gjin Bue Shpata, nr.8, Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +42229800

E-mail: [info@institutemedia.org](mailto:info@institutemedia.org)

[www.institutemedia.org](http://www.institutemedia.org)

© ISHM



*Ky dokument është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.*

## Treguesi i lëndës

<b>Hyrje</b> .....	5
<b>Peizazhi mediatik</b> .....	6
<b>Përpyjekjet për të rregulluar procesin e kalimit në dixhital</b> .....	7
<b>Legjislacioni aktual për transmetimet dixhitale</b> .....	11
<b>Përpyjekjet për të zbatuar procesin e kalimit në dixhital</b> .....	16
- <i>Funksionimi i autoritetit rregullator</i> .....	17
- <i>Problemet në dixhitalizimin e transmetuesit publik</i> ...	21
- <i>Licensimi i rrjeteve komerciale dixhitale</i> .....	24
- <i>Transmetuesit lokalë në kontekstin e dixhitalizimit</i> ...	29
- <i>Përgjegjësi dhe transparencë ndaj publikut</i> .....	30
<b>Përfundime</b> .....	32



## Hyrje

Megjithëse Shqipëria ishte një nga vendet e para në Ballkan ku filloi transmetimin multipleksi i parë në vitin 2004, tani që afati i fundit zyrtar për kalimin në transmetime dixhitale pothuajse ka mbërritur, ajo ka mbetur mbrapa në krahasim me të gjithë vendet e Rajonit. Cilët janë rrënjët e këtij procesi, i cili filloi me nxitim dhe u ngadalësua në gjysëm të rrugës? Raporti ka për qëllim të merret me këtë çështje, të analizojë disa nga hapat dhe faktorët kyç si hartimi i legjislacionit, influenca e klimës politike mbi institucionet, aftësitë e zbatimit nga institucionet, influencat e interesave të biznesit, roli i transmetuesit publik dhe operatorëve lokalë si dhe përgjegjësia ndaj publikut në këtë aspekt.

## Peizazhi mediatik

Shqipëria ka një peizazh të pasur dhe dinamik të medias, me rreth 250 organe të medias, 25 gazeta të përditshme. Për momentin ka dy televizione kombëtare komerciale, TV Klan dhe Top Channel TV, 64 televizione lokale analoge dhe 115 televizione lokale kabllorë<sup>1</sup>. Nga të gjithë stacionet televizive ekzistuese analoge, transmetuesi publik Radio Televizioni Shqiptare (RTSH) ka shtrirjen më të madhe: sinjali i tij mbulon 87 përqind të territorit<sup>2</sup>. Gjithashtu ka edhe tre platforma dixhitale , Digitalb, Tring dhe Supersport. Supersporti është pjesë e platformës Digitalb.

Përveç këtyre ka edhe 65 stacione radios lokale dhe dy kombëtare Top Albania Radio dhe +2 Radio, si dhe transmetuesi publik Radio Tirana.<sup>3</sup> Megjithatë, stacionet e radios janë më tepër mjete zbavitje me muzikë kryesisht, e ndërthurur me lajme flesh dhe programe talk show.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup> AMA: <http://ama.gov.al/preview/mediat/tv/> , <http://ama.gov.al/preview/mediat/kabllor/>

<sup>2</sup> AMA, Raporti Vjetor 2014, f. 9

<sup>3</sup> AMA Lista e transmetuesve radiofonik: <http://ama.gov.al/preview/mediat/radio/>

<sup>4</sup> AMI, Media dhe shoqëria e informacionit ne Shqipëri, Tirana, 2011, fq.8.

## **Përprojekjet për të rregulluar procesin e kalimit në dixhital**

Në përgjithësi duke marrë parasysh historinë dhe natyrën e zhvillimeve me median audiovizuale në vend, legjislacioni dhe rregullatori kanë pasuar zhvillimin e mediave dhe prirjeve, zakonisht duke nxjerrë ligje që krijoheshin për të rregulluar atë që tashmë ishte në treg. Shembulli më i dukshëm i legjislacionit që pason zhvillimet në terren është ndoshta rasti i kalimit në transmetime dixhitale. Platforma e parë dixhitale, Digitalb, filloi transmetimin në vitin 2004, kur as rregullatori dhe as ligjvënësit nuk kishin diskutuar apo nxjerrë rregulla mbi transmetimin dixhital. Kjo ardhje e re në skenën e medias shqiptare, shpejt u pasua nga një tjetër platformë dixhitale, kësaj here satelitore, SAT+. Mbas shumë debatesh në lidhje me përprojekjet për të rregulluar keto kompani që pasuan nga autoriteti rregullues, Parlamenti, organizatat ndërkombëtare dhe perfaqësuesit e medias, ata u bënë një realitet i qëndrueshëm dhe konkurses e serioz në peisazhin mediatik shqiptar, megjithëse ato ishin “të jashtëligjshëm” në aspektin e legjislacionit të medias.

Duke u ballafaquar me një presion në rritje të planeve të shpallura për të filluar një televizion dixhital, autoriteti rregullues punoi për të hartuar një strategji për kalimin në dixhital dhe si rrjedhim për të ndryshuar dhe ligjin mbi



transmetimin. Drafti i parë i Strategjisë për Transmetime Dixhitale u hartua në vitin 2005 nga rregullatori, Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit, me ekspertizë ndërkombëtare. Kjo strategji përmbante një analizë të shkurtër të situatës ekzistuese deri në atë moment në lidhje me planin e frekuencave dhe zhvillimeve të sektorit të televizionit, një vëzhgim të avantazheve dhe mangësive të futjes së televizionit dixhital, skenarët e mundshëm, kriteret e licensimit dhe një plan potencial për kalimin si dhe rekomandimet për suksesin e tij.

Paralel me këtë strategji, pati dhe një iniciativë për të amenduar ligjin ekzistues mbi transmetimin me qëllim për të përfshirë edhe transmetimin dixhital. Grupi i punës përbehej nga ish anëtarë të Komisionit Parlamentar të Medias, punonjës të KKRT dhe ekspertë të huaj të porositur nga Prezenca e OSBE në Shqipëri. Megjithatë, ndërsa po hartoheshin shtesat, një iniciativë për të kaluar ligjin mbi televizionin dixhital u paraqit nga një grup parlamentarësh. Në fund ky version i ligjit shkoj deri në sesionin e fundit parlamentar, por për shkak të votave kundër nuk kalij. Si ky version i ligjit ashtu dhe tjetri i hartuar nga rregullatorët u gjykuan si të pamjaftueshmë dhe me gabime të rënda nga ana e ekspertëve të huaj<sup>5</sup>. Si pasojë platforma ekzistuese dixhitale vazhdoi të funksiononte dhe dy të tjera u shfaqën në vitet në vazhdim si Tring dhe Supersport.

Iniciativa tjetër për të rregulluar sektorin e mediave elektronike dhe për të hapur rrugën për transmetimin

---

<sup>5</sup> ISHM, "Televizioni Dixhital në Shqipëri: Politikat, zhvillimi, dhe debati publik," 2006.

dixhital erdhi në vitin 2007, kur u miratua Ligji mbi Transmetimet Numerike. Sipas ligjit të transmetimit, rregullatori KKRT ishte përgjegjës për dhënien e tre llojeve të licensave: për siguruesit e shërbimit, operatorët e rrjetit dhe siguruesit e përmbajtjes. Ligji i detyronte operatorët analogë të transmetonin në mënyrë simultane në analog dhe dixhital deri sa përqindja e familjeve që merrnin sinjalin analog të zbriste poshtë 10 përqindshit në atë zonë ku ata transmetonin. Ndërsa në anën tjetër, transmetuesi publik RTSH kishte të drejtën të perdorte dy nga shtatë frekuencat në shkallë vendi të caktuara nga RRC-06 për Shqipërinë për përdorim dixhital. Ligji gjithashtu vendoste disa detyrime mbi rrjetin e operatorëve dixhital. Ata duhet të ofronin të paktën 50 përqind të shërbimeve të transmetimit falas, ndërsa transmetuesi i shërbimit publik nuk do të kërkonte pagesë për asnjë nga programet e tij. Përveç kësaj transmetuesit dixhitalë duhet të ishin konform me disa kërkesa të tjera duke përfshirë paanshmërinë dhe pavarësinë editoriale në lajmet dhe shërbimet e tyre të informacionit. Në pamje të parë kriteret e licensimit dukeshin të drejta dhe të orientuara drejt publikut, veçanërisht në lidhje me theksin në zgjedhjen e aksesit universal, transparencën e shpenzimeve dhe përzgjedhjen e gjërë mbi përmbajtjen.

Qeveria e paraqiti ligjin në Parlament në shkurt të 2007, në një kohë kur Parlamenti tashmë e kishte adoptuar – në bashkëpunim me Këshillin e Evropës – një plan veprimi për të rishikuar legjislacionin e medias dhe për të hartuar një ligj mbi transmetimin dixhital nga fundi i vitit.

Pronarët e mediave dhe drejtorët protestuan duke thënë se ata nuk ishin konsultuar mbi këtë ligj të rëndësishëm. Debatet që i paraprinë ndryshimit të ligjit u fokusuan mbi impaktin e tij në tregun aktual ku DigitAlb ishte bërë një lojtar i suksesshëm. Përfaqesuesit e DigitAlb insistuan se ata nuk kërkonin gjë tjetër vetëm legalizimin e aktivitetit të tyre pa qenë nevoja që të fillonin nga e para.<sup>6</sup> Pas disa dëgjësive me palët e interesuara duke marrë komente dhe sugjerime nga OSBE, Këshilli i Evropës dhe Komisioni Evropian, shumica në Parlament e kaloi ligjin pa marrë pëlqimin e opozitës e cila refuzoi ta votonte. Debati mbi shtesat në ligj pothuajse nuk u fokusua tek efektet dhe qëllimi i tij, gjë që ngriti pyetjen se sa efikas do të jetë ky ligj nëse zbatohet. Në fakt procesi i licensimit dixhital nuk filloi asnjëherë dhe ligji nuk u zbatua kurrë.

---

<sup>6</sup> Procesverbalimbledhjes në Komisionin e Medias, 20 prill 2007: <http://www.parlament.al/dokumenti.asp?id=2351&kujam=Komisioni> (accessed 18 October 2007).

## **Legjislacioni aktual për transmetimet dixhitale**

Përprojekjet për të rregulluar me ligj kalimin në dixhital kanë vazhduar gjatë dhe hartimi i politikave dhe zbatimi i tyre kanë qenë të ngadalta dhe shpesh procesi edhe është bllokuar. Për shkak të arsyeve të ndryshme transmetuesit dixhitalë kanë operuar për rreth dhjetë vjet në mungesën e përpjekjeve për ta rregulluar këtë sektor dhe rregulluesit e medias tani janë gjendur përballë me një *fait accompli* që nuk mund të injorohet dhe duhet të jete pjese e rregullave dhe politikave të ardhshme në media.

Ndërsa Plani i Veprimit i firmosur nga Qeveria me Këshillin e Evropës në 2006 përfshinte gjithashtu hartimin në Parlament të një ligji të ri për mediat audiovizuale. Qeveria aprovoi në 2 Maj 2012 Strategjinë për Kalimin në Transmetime Numerike, që do të hapte rrugën për nisjen zyrtare të kalimit në transmetimin dixhital. Që nga version i parë i strategjisë së këtij procesi në 2005, janë bërë disa përpjekje për të hartuar, rishikuar dhe aprovuar këtë strategji. Ky version i kësaj strategjie kaloi nëpërmjet punës së një komisioni ad-hoc, i përbërë nga ministrinë përgjegjëse, transmetuesi publik, autoriteti rregullator i medias elektronike, përfaqësues të medias elektronike etj. Pas aprovimit të Strategjisë, kreu i KKRT bëri apel për një aprovim të shpejtë të projekt ligjit për

Shërbimet Audiovizuale, i cili vazhdoi të diskutohet në Parlament, me qëllim që si Strategjia dhe ligji i ri të fillojnë të zbatohen. Megjithatë u desh edhe një vit tjetër të finalizohet dhe aprovohej ligji i ri, Ligji 97/2013 “Për Median Audiovizuale,” i aprovuar në mars të 2013.

Situata e zgjatur mbi transmetimin pa rregulla rezultoi në ballafaqimin me disa sfida në lidhje me kalimin në dixhital. Këto sfida konsistojnë në garantimin e konkurrencës së drejtë dhe të lirë në treg, duke ruajtur njëkohësisht investimet e bëra, duke u kujdesur që interesi publik është mbi çdo interes biznesi, duke mundësuar akses dhe kushte të drejta për operatorët lokalë, duke garantuar tranzicionin në kalimin në dixhital të transmetuesit publik së bashku me garancitë e përmbushjes së misionit publik, duke siguruar informacion të mjaftueshëm, ekspertizë, si dhe fonde për publikun që nuk është në gjendje të paguajë për kalimin në dixhital, etj. Strategjia trajton këto çështje duke nënvizuar kufizimet për pronësinë e shumëfishtë, fondet për fushatat e ndërgjegjësimet të publikut si dhe ndihmën për dekoderat, kostot e kalimit të transmetuesit publik si dhe licensat e multiplekseve komerciale. Qëllimi i Strategjisë ishte vendosja e piketave të nevojshme për kalimin përfundimtar që supozohej të arrihej në 17 Qershor, 2015. Për këtë qëllim një komitet ndër institucional u ngrit, i cili do të mbikqyrte zbatimin e kalimit.

Mbas aprovimit të Strategjisë për Kalimin në Transmetime Numerike, më 4 Mars 2013, Parlamenti Shqiptar aprovoi Ligjin 97/2013 “Për Mediat Audiovizuale në Republikën e Shqipërisë,” mbas vitesh diskutimesh dhe

bllokimi. Ky ligj ka si qëllim harmonizimin e legjislacionit shqiptar të medias me Direktivat e Shërbimeve të Medias Audiovizuale (2010/13/EU – AVMSD) të Bashkimit Evropian si dhe t’i përgjigjet realitetit të sektorit të mediave audiovizuale. Të dy krahët e politikës ranë në konsensus për ligjin, me përjashtim të procedurës së zgjedhjes së anëtarëve të autoritetit rregullator. Në fakt mos rënia dakort mbi një formulë të përshtatshme ka rezultuar të jetë një sfidë e vazhdueshme dhe shkak për luftë politike.

Ligji i dha kompetenca te reja autoritetit rregullator, tani i quajtur Autoriteti i Medias Audiovizuale (AMA). Autoriteti jep autorizime dhe licensa për transmetimin dixhital, përgatit udhëzime dhe rregulla mbi përdorimin e infrastrukturës së transmetuesit publik, shqyrtimin e mosmarrëveshjeve mes operatorëve dhe përgatit studime dhe punë kërkimore në sektorin e mediave audiovizuale.

AMA po ecën ngadalë në të gjithë parametrat e saj, veçanërisht në kalimin në dixhital si rezultat i mosmarrëveshjeve politike mes opozitës dhe mazhorancës. Të dyja palët nuk bien dakort mbi përberjen e këshillit të ri me anëtarë mangut si dhe pati një debat mbi vlefshmërinë e mandatit të ish-kryetarit të AMA. Procesi u zvarrit për një kohë të gjatë dhe çështja është akoma në gjykatë. Momentalisht AMA nuk e ka kuorumin e nevojshëm për të marrë disa vendime për shkak të mungesës së një anëtari dhe refuzimit të anëtarëve të caktuar nga opozita për të marrë pjesë në proceset vendim marrëse. Ndërkohë AMA ka aprovuar rregulloren “Mbi licensimin e rrjeteve dixhitale dhe programeve që mbështeten tek ato nëpërmjet

procedurës së Beauty Contest,” duke filluar me procesin e licensimit që fton operatorët historikë të marrin pjesë në konkurrim.

Në fund të Mars 2015 AMA hartoi një plan pune për procesin e kalimit në dixhital duke detajuar detyrat që duhet të përfundonin në harkun kohor Shkurt – Qershor 2015<sup>7</sup>. Plani i punës përfshin tre fusha kryesore: hartimi i rregullave që do të mundësojnë fillimin e kalimit në dixhital, marrëveshjen me transmetuesin publik mbi planin e kalimit, komunikimin dhe rënien dakort me operatorët lokal analogë, komunikimin me ITU, fondet shtetërore e duhura dhe fushata për ndërgjegjësimin publik. Më konkretisht, plani i punës përfshin detyrat e mëposhtme:

- Rishikimi i rregullores së “Beauty Contest”. Kjo ishte hartuar, konsultuar dhe aprovuar në Korrik 2013 dhe u rishikua.
- Rregullimi mbi planin e renditjes së programeve. Rregullimi mbi aksesin e kushtëzuar është hartuar, por ka nevojë të rishikohet dhe duhet të ketë përfunduar më 20 Prill.

Veç kesaj, bashkëpunimi i AMA me transmetuesin publik RTSH është pjesë e rëndësishme e planit:

- Caktimi i kriterëve dhe i numrit të programeve të natyrës publike, atyre të transmetimit falas dhe atyre me akses të kushtëzuar.
- Vendosja e kriterëve dhe kontratave që RTSH dhe operatorët lokal do të nënshkruajnë për të

---

<sup>7</sup> <http://ama.gov.al/preview/wp-content/uploads/2015/03/planipunessprdigitalizimin.pdf>

përdorur rrjetin e operatorit publik. Njëkohësisht çështja e tarifave që operatorët duhet të paguajnë për të përdorur këte rrjet duhet diskutuar. Operatorët lokalë supozohen të jenë pjesë e diskutimit.

- Rregullat mbi kriteret dhe masat rregulluese për përdorim të përbashkët të infrastrukturës së transmetuesit RTSH duhet rishikuar.

Plani për rrjetet lokale të analogëve konsiston në:

- Dixhitalizimi i rrjeteve analoge lokale.
- Në varësi të progresit të ndërtimit të rrjeteve të RTSH, plani për mbulimin e secilit operator dhe plani i veprimit duhet të hartohen, duke koordinuar përdorimin e rrjeteve publike nga ana e operatorëve privatë lokalë.
- Detyrat e fushatës së informimit publik përfshijnë planet e mëposhtme:
  1. Një call-center duhet të krijohet. Fondet duhet të sigurohen, stafi duhet të trajnohet dhe manualet duhet të jenë gati që stafi t'i ketë për përdorim.
  2. Fushatë për informimin publik në media. Një broshurë informuese duhet të hartohet.
  3. Organizimi i konferencave për të rritur ndërgjegjësimin mbi kalimin në dixhital. Tre konferenca rajonale dhe një kombëtare do të organizohen, por koha varet në caktimin e rregullave dhe kriterëve që do të prezantohen në konferencë.



## **Përppjekjet për të zbatuar procesin e kalimit në dixhital**

Zbatimi i Strategjisë për Kalimet në Transmetime Numerike dhe Ligji për Median Audiovizuale ka qenë shumë i ngadaltë. Dy ditë para afatit përfundimtar në Qershor 17, 2015, i caktuar për kalimin në dixhital për kontinentin evropian, AMA botoi një njoftim për shtyp që njoftonte se afati përfundimtar për kalimin në dixhital ishte i pamundur për tu realizuar në situatën aktuale: “AMA njoftoi Parlamentin e Shqipërisë, Qeverinë, Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike, AKEP, RTSH dhe subjektet audiovizuale që kane lidhje me problemet në mënyrë direkte influencojnë procesin e kalimit në dixhital si: kërkesa e menjëhershme për të filluar ndërtimin e rrjeteve dixhitale të RTSH, kompletimin e bordit të AMA me një anëtar që mungon dhe të mundësisë që AMA të marri vendime që kërkojnë një kuorum. Duke marrë parasysh të gjitha këto si dhe të gjithë masat e marra është i pamundur implementimi i plotë i Strategjisë për Kalimin në Dixhital si dhe afati përfundimtar i mbylles së transmetuesve analoge, i caktuar për 17 qershor, 2015, nuk mund të arrihet.”<sup>8</sup>

Arsyet e vonesës për kalimin në dixhital janë komplekse dhe të lidhura me probleme të thella të medias

---

<sup>8</sup> Njoftim për shtyp i AMA, 15 qershor, 2015.

shqiptare dhe mënyrës së funksionimit të saj. Me qëllim për të kuptuar dinamikat e këtij procesi dhe faktorët që pengojnë përfundimin e tij, analiza e mëposhtme do të trajtojë situatën me autoritetin rregullues, funksionimin dhe pushtetin e tij; problemet me dixhitalizimin e transmetuesit publik, rolin e medias komerciale në procesin e kalimit në dixhital, situatën e operatorëve lokalë dhe përgjegjësitë e autoriteteve dhe medias ndaj publikut në këtë proces.

### **- *Funksionimi i autoritetit rregullator***

Siç është përmendur shkurtimisht më sipër, autoriteti rregullator nuk ka qenë në gjëndje të performoje normalisht në procesin e licensimit dhe të kalimit në dixhital për shkak të problemeve në funksionimin dhe përberjen e tij. Rotacioni i pushtetit pas zgjedhjeve në qershor 2013 në Shqipëri solli edhe njëhere në krye të debatit zgjedhjen e autoritetit rregullator të medias që mbikqyr zbatimin e ligjit nga ana e operatorëve mediatikë audiovizualë dhe Këshillit Drejtues të RTSH, që është organi më i lartë qeverisës i transmetuesit publik. Ndërsa formula për zgjedhjen e anëtarëve ka ndryshuar disa herë, ligjvënësit akoma nuk kanë gjetur nje rrugë për të kaluar vonesat dhe pengesat për funksionimin e rregullatorëve për shkak të mungesës së anëtarëve apo bllokimit politik. Formula aktuale nuk është përjashtim. Ligji “Për Median Audiovizuale” u adoptua në Mars 2013, mbas më shumë se gjashtë vjetësh diskutimesh, rishikimesh, rihartimesh

dhe konsultimesh me ekspertë dhe palë të interesuara. Varianti final i ligjit që u soll para parlamentit ishte një produkt i marrëveshjes mes dy krahëve politikë, me përjashtim të formulës mbi zgjedhjen e autoritetit rregullator dhe të Këshillit Drejtues të transmetuesit publik. Pas dështimit në arritjen e konsensusit, propozimi i ish mazhorancës për këtë formulë kaloi vetëm me votat e shumicës.<sup>9</sup> Sipas rregullave aktuale kryetari i AMA do të zgjidhet me shumicën e thjeshtë të votave, që do të thotë që kryetari i autoritetit rregullator do të jetë i lidhur përsëri me votat e parlamentarëve, pasi ai/ajo do të zgjidhet përmes shumicës së votave, pa qenë nevoja për konsensus të detyrueshëm apo ndonjë lloj përfaqësimi më të gjerë. E njëjta gjë vlen për kryetarin e Këshillit Drejtues të RTSH.<sup>10</sup> Kështu që ligji i ri nuk i hoqi dyshimet mbi pavarësinë nga faktori politik brenda rregullatorëve. “Procedurat e caktimit të anëtarëve të autoritetit rregullator të medias AMA nuk garantojnë plotësisht pavarësinë e tyre.”<sup>11</sup>

Kjo pamundesë për të rënë dakort mbi çështje të rëndësishme mbi legjislacionin e medias në një farë mënyre paralajmëroi betejën që vijoi për zgjedhjen e anëtarëve të autoritetit rregullator. Me betimin e Parlamentit të ri në shtator 2013, një nga detyrat e para të Komisionit Parlamentar të Medias ishte propozimi për anëtarët e rinj

---

<sup>9</sup> ISHM, <http://institutemedia.org/newsletter.html#march>, mars 2013.

<sup>10</sup> Ligji 97/2013, “Për Median Audiovizuale,” Art. 95.

<sup>11</sup> Progres Raporti i BE, 2013, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/brochures/albania\\_2013.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/albania_2013.pdf)

të AMA dhe Këshillit Drejtues të transmetuesit publik. Mandatet e 11 anëtarëve të Këshillit Drejtues kishin përfunduar prej më shumë se një viti. Autoriteti i Medias Audiovizuale kishin një anëtar që i ka mbaruar mandati, ndërkohë që kishte dhe dy vende bosh pasi ish opozita nuk kishte caktuar kandidatë për këto poste si pjesë e një vendimi politik që ajo kishte marrë në atë kohë. Ndërsa kjo do të ishte një proces rutinë, zgjedhja e anëtarëve të rinj për të dyja organet rezultoi të ishte një proces i gjatë, i vështirë dhe polemizues.

Komisioni Parlamentar i Medias për shumë muaj nuk ra dakort mbi termat e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të AMA. Mazhoranca pretendonte se ishte e paligjshme që kryetarja e AMA të mbante pozicionin e saj pasi mandati i saj kishte mbaruar dhe ajo nuk ishte rizgjedhur si anëtare e AMA, duke akuzuar opozitën se po bllokonte procesin e kthimit të rregullatorit në një proces normal. Në anën tjetër opozita argumentonte se mazhoranca po shkelte ligjin me qëllim që ta kontrollonte politikisht rregullatorin. Me pak fjalë beteja politike dhe debati i gjatë vonuan zgjedhjen e anëtarëve të rinj duke paralizuar si AMA dhe Këshillin Drejtues dhe si rrjedhim duke vonuar kalimin në dixhital dhe proceset e tjera. Më në fund Parlamenti zgjodhi kryetarin dhe dy anëtarët e rinj të organit rregullator vetëm me votat e shumicës. Opozita e denoncoi procesin duke thënë se ligji qartësisht kërkon që lista e kandidatëve të përpilohen në bashkëpunim nga mazhoranca dhe opozita. Përveç kësaj opozita kontestoi edhe zgjedhjen e kryetarit duke thënë se eksperiencia e tij

e mëparshme si drejtor i një nga platformave komerciale kryesore në vend ishte tregues se si qeveria dhe media komerciale po përpiqeshin të kapnin për interesat e tyre rregullatorin. Aktualisht çështja është në gjykatën administrative. Në këtë kontekst dy nga anëtarët e mbetur të AMA të caktuar nga opozita kanë refuzuar të marrin pjesë në vendimmarrje derisa gjykata të vendosë mbi këtë çështje që do të thotë se AMA-s i mungon kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime të rëndësishme që kërkojnë pesë vota. Kjo ka ndikuar negativisht në procesin e kalimit në dixhital, pasi kjo është një nga arsyet që e pengon AMA të vendosë mbi dhënien e licensave dixhitale si dhe për vendime të tjera.

Situata për zgjedhjen e Këshillit Drejtues të RTSH ka qenë e njëjtë kur Parlamenti zgjodhi më 4 Dhjetor 2014, në një sesion plenar pesë anëtarët e Këshillit Drejtues të transmetuesit publik RTSH. Anëtarët e rinj u votuan vetëm nga parlamentarët e mazhorancës ndërkohë që opozita vazhdonte të bojkotonte të gjitha aktivitetet parlamentare. Opozita edhe këtë çështje e çoi në Gjykatë por vendosi të mos ta ndiqte më tej dhe vazhdoi me kompletimin e Këshillit Drejtues dhe zgjedhjen e kryetarit të tij. Megjithatë Këshilli është bllokuar në lidhje me zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të ri të RTSH. Si vonesa në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues ashtu dhe bllokimi në zgjedhjen e drejtorit të ri kanë influencuar negativisht në aftësinë drejtuese të RTSH për të aprovuar dokumentat e nevojshëm që duhen për procesin e kalimit në dixhital.

## ***- Problemet në dixhitalizimin e transmetuesit publik***

Transmetuesi publik supozohet të ketë një rol udhëheqës në procesin e kalimit në transmetime dixhital. Përveç funksionimit të kufizuar të Këshillit Drejtues dhe vonesave të vazhdueshme, një problem i madh në procesin e dixhitalizimit të RTSH kishte të bënte me konfliktin ligjor mbi tenderin e dixhitalizimit të dy rrjeteve të tij. Strategjia për Kalimin në Transmetime Numerike i dha dy frekuenca kombëtare transmetuesit publik, nga tetë që i janë caktuar Shqipërisë. Në pamundësi për të ndërtuar dy rrjete të saj, Ministria e Inovacionit dhe ICT publikoi një thirrje për propozim në 12 prill, 2013 “Për Financimin, Modelimin, Furnizimin, Instalimin, Trainimin dhe Transferimin e një Rrjeti DVB-T2 për Republikën e Shqipërisë.” Qëllimi i tenderit i shpallur nga Ministria ishte përzgjedhja e një kompanie që do të ndërtonte rrjetin dixhital i cili do të mundësonte transmetuesin publik të kalonte nga analog në rrjetin dixhital. Tenderi u zhvillua mes debatesh të opozitës që deklaronte se nuk ishte momenti i përshtatshëm për ndërmarrjen e projekteve të këtyre përmasave menjëherë para periudhës zgjedhore. Katër kompani aplikuan për këtë tender dhe Ministria shpalli dy fitues në qershor me anë të Urdhërit nr.11, datë 17/06/2013: Rohde & Schwarz dhe Ericsson AB. Sipas Ministrisë, të dyja kompanitë në fillim shprehën dëshirën e tyre të zbatonin kontratat, por kompania Rohde & Schwarz dërgoi mesazhe Ministrissë në korrik 2013, duke u ankuar për procedurën. Ministria

vendosi ta përjashtonte kompaninë nga tenderi mbasi kompania dështoi në qartësimin e pozicionit të saj pas kërkesës së Ministrisë. Pas përjashtimit kompania ngriti padi më 15 gusht 2013 në Gjykatën e Tiranës, e cila e refuzoi kërkesën pas katër ditësh. E përballur me këtë situatë dhe me një rotacion të menjëhershëm të pushtetit pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2013, Ministri nxorri Urdhërin nr.15, datë 29/08/2013, një urdhër që anulonte të gjitha procedurat e tenderit.

Kompania Rohde & Schwarz ngriti një padi tjetër, duke sfiduar si anullimin ashtu dhe shpalljen e dy fituesve të tenderit, të cilën Gjykata e Tiranës e pranoi me një vendim nr. 12316, datë 09.12.2013<sup>12</sup>. Vendimi i gjykatës gjithashtu vendosi që urdhëri i nxjerrë nga ministria duke shpallur dy fitues të tenderit, ishte i paligjshëm dhe si pasojë e anuloi urdhrin që anulonte procedurat e tenderit në gusht 2013. Ministria e apeloj vendimin e gjykatës. Gjykata e Apelit vendosi nëpërmjet vendimit nr. 2712, datë 18.06.2014<sup>13</sup>, që çështja duhej të transferohej në Gjykatën Administrative të Apelit pasi çështja ishte nën juridiksionin e tyre. Në këtë moment Ministria vendosi të ndalonte apelimin e çështjes dhe Gjykata Administrative e Apelit nxorri Vendimin nr.3407, datë 15.09.2014<sup>14</sup>, e cila vendosi që çështja ishte mbyllur. Menjëherë pas vendimit të gjykatës Urdhër nr.3663, datë 29.09.2014, u publikua në

---

<sup>12</sup> [www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al)

<sup>13</sup> <http://www.gjykataeapelittirane.al/>

<sup>14</sup> <http://www.gjykataadministrativeapelit.al/>

Buletinin për Prokurimet Publike nr.41, datë 13.10.2014<sup>15</sup>, i cili e shpallte kompaninë Rohde & Schwarz si fituesin e vetëm të tenderit për ndërtimin e rrjeteve dixhitale për transmetuesin publik RTSH.

Mbas këtyre procedurave vendimi përfundmtar i Ministrisë u sfidua nga ofertuesi tjetër i tenderit kompania Ericsson AB, si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese vendosi ta refuzonte akt padinë. Vendimi nr.195, datë 05.12.2014<sup>16</sup>, deklaronte se kompania Ericsson AB po kërkonte të riapelonte një vendim gjykate ë cili rezultoi nga një proces në të cilin kompania nuk ishte palë dhe kështu nuk ishte në gjendje të apelonte vendimin. Gjykata gjithashtu deklaroi se kompania nuk i kishte ezauruar të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe si pasojë nuk kishte pse ta paraqiste kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

Mbasi u mbyll kjo odise ligjore, RTSH dhe qeveria nënshkruan kontratën me kompaninë gjermane Rohde & Schwarz më 19 mars, 2015. Megjithatë duke marrë parasysh vonesat në formimin e Këshillit Drejtues dhe në zgjedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe vonesat e shkaktuara nga mosmarrëveshjet ligjore, ngritja e rrjeteve dixhitale është vonuar shumë duke influencuar kështu jo vetëm RTSH, por edhe transmetuesit lokalë që supozohen t'i përdorin këto rrjete.

---

<sup>15</sup> [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

<sup>16</sup> <http://www.gjk.gov.al/>



## ***- Licensimi i rrjeteve komerciale dixhitale***

Përveç funksionimit të kushtëzuar të autoritetit rregullator dhe vonesave në nënshkrimin e kontratës për ngritjen e rrjeteve dixhitale të RTSH, procesi i licensimit të rrjeteve komerciale dixhitale nuk ka qenë i qetë. Me vendimin “Mbi licensimin e rrjeteve dixhitale dhe programeve të tyre nëpërmjet procedurave të beauty contest,” datë 2 korrik, 2013, rregullatori AMA bëri thirrje për licensimin e operatorëve komercialë dixhitalë, duke ftuar operatorët historikë të aplikojnë. Të tre operatorët, Digitalb, Top Channel, dhe Media 6, ngritën një padi duke kundërshtuar Paragrafin 16 të kesaj rregulloreje. Ata gjithashtu kërkuan se bazuar në pavlefshmërinë e këtij paragrafi, gjykata duhet ta shpallte si të pa vlefshëm të gjithë rregulloren. Operatorët pretendojnin se AMA ka vepruar përtej kompetencave të saj në vendosjen e masave financiare që operatorët duhet të përmbushin për të marrë një licensë. AMA argumentoi se operatorët nuk i kishin ezauruar të gjitha masat ligjore dhe se ata fillimisht duhet të kishin bërë ankesën administrative. Në 30 korrik, 2013, gjykata hodhi poshtë argumentin e AMAs dhe vendosi të pranonte procedimin e Digitalb, Top Channel & Media 6 dhe pezulloi rregulloren<sup>17</sup>. Gjykata e shkallës së parë vendosi që AMA nuk kishte paraqitur prova të mjaftueshme për këto pretendime. Si rrjedhim rregullat dhe procedurat

---

<sup>17</sup> [www.gjykatatirana.gov.al](http://www.gjykatatirana.gov.al)

mbi licensimin e rrjeteve dixhitale u pezulluan deri në vendimin përfundimtar të gjykatës.

AMA e apeloj vendimin e gjykatës për pezullimin e rregullores në Gjykatën e Apelit më 5 Gusht 2013, dhe më vonë në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë kerkoi plotësimin e dosjes ligjore nga një gjykatë e shkallës së parë, e cila u përgjgj se aktualisht dosja po shqyrtohet në shkallë të parë të Gjykatës Administrative. Kjo ishte pas vendimit të marrë nga Gjykata e Tiranës në 21 Janar, 2014. Gjykata e shkallës së parë kishte vendosur se objekti i kësaj padie kishte lidhje me procedurat administrative. Si rezultat gjykata u deklarua jo kompetente për t'u marrë me këtë çështje duke i dërguar vendimet në gjykatën kompetente, të quajtur niveli i parë i Gjykatës Administrative të Tiranës. Pasi shqyrtoi të gjitha aktet ligjore të dosjes, Gjykata e Lartë deklaroi se vendimi i shkallës së parë për të refuzuar kërkesën e AMAs që konsideronte padinë e operatorëve si jo ligjore, në bazë të mosezaurimit të ankesës administrative, ishte i vlefshëm.

Paralel me vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë, pas vendimeve të Gjykatës së Tiranës datë 21 Janar, 2014, padia e Digitalb, Top Channel & Media 6 vs AMA u shqyrtua nga shkalla e parë e Gjykatës Administrative dhe pastaj nga Gjykata Administrative e Apelit. Kjo e fundit e pranoi padinë me Vendim nr.17, datë 8 Tetor, 2014<sup>18</sup>, duke anuluar paragrafin 16 të rregullores dhe duke zbatuar pezullimin e procesit te lincensimit.

---

<sup>18</sup> <http://www.gjykataadministrativeapelit.al/>

Së fundmi padia dhe vlefshmëria e Vendimit të Gjykatës së Tiranës për ta transferuar akt padinë në Gjykatën Administrative u mor parasysh nga Gjykata e Apelit. Në 17 Tetor, 2014, kjo gjykatë konfirmoi se Gjykata e Tiranës kishte të drejtë që transferoi akt padinë, pasi i mungonin kompetencat për të vendosur mbi këtë çështje. Për më tepër vendimi u mor pasi si AMA dhe përfaqësuesi i Avokatit të Shtetit deklaruan se të dyja shkallët e Gjykatës Administrative kishin vendosur mbi këtë çështje duke e konsideruar atë si të mbyllur. Si rezultat pas këtyre vendimeve të gjykatës si dhe zgjedhjes së anëtarëve të rinj të AMA, organi rregullator vendosi të pushonte procedimin ligjor dhe të amendonte rregulloren. Megjithëse rregullatori ishte i lirë të procedonte më shumë se një vit shkoi dëm në mosmarrëveshje ligjore mbi këtë çështje.

Rregullatori më në fund rishikoi rregullat mbi licensimin dhe mbas konsultave me operatorët ekzistues bëri thirrje për aplikim në prill 2015<sup>19</sup>. Thirrja u kontestua nga Vizion+ dhe Tring TV, duke kërkuar pezullimin e procedurave. Aktualisht çështja është në gjykatë dhe Tring, megjithëse u ftua të merrte pjesë nuk aplikoi. Katër operatorët historikë morën pjesë në garë, dy televizionet kombëtare TV Klan dhe Top Channel, dhe dy platformat ekzistuese dixhitale: Digitalb dhe Supersport. Mbetet për t'u parë nëse AMA do të jetë në gjendje të marrë vendime mbi licensat për shkak të mungesës së kuorumit në bordin e saj.

---

<sup>19</sup> [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)

Për më tepër edhe me katër aplikantë, ka një problem lidhur me strukturën e tyre të pronësisë dhe kërkesës ligjore të imponuar në këtë aspekt. Përderisa tre nga katër operatorët kanë pak a shumë të njëjtët pronarë, kufizimi aktual i pronësisë në Ligjin për Median Audiovizuale është pengesë për marrjen e licensave respektive. Sipas paragrafit 62 mbi Ligjin për Median Audiovizuale, “asnjë person ligjor i huaj apo vendas nuk duhet të ketë më shumë se 40 përqind të kapitalit të përgjithshëm të një kompanie të përbashkët që ka një licensë kombëtare transmetimi apo një licensë kombëtare për transmetime audiovizuale.”<sup>20</sup> Për më tepër pronari i një kompanie me licensë kombëtare nuk mund të zotërojë më shumë se 20% në një kompani tjetër që posedon një licensë kombëtare. Ky rregull qartësisht kufizon numrin e licensave kombëtare që AMA mund t’i japë aplikantëve aktualë me strukturën e tyre të pronësisë.

Në këtë kontekst Taulant Balla, deputet i Partisë Socialiste, në 24 prill 2015 paraqiti një propozim në Parlament për amendimin e Ligjit për Median Audiovizuale. Ndryshimi i propozuar përmbante vetëm paragrafin e mëposhtëm: “Paragrafi 62 i ligjit nr. 97/2013 ‘Mbi median audiovizuale në Republikën e Shqipërisë’ shfuqizohet.” Ndryshimi i propozuar nga Balla pretendon se ky paragraf ka krijuar pengesa që duhet të eliminohen pasi ato përbëjnë “një pengesë reale ndaj zhvillimit të transmetimit.” Sipas raportit që shoqëron ndryshimin

---

<sup>20</sup> Ligji 97/2013, parag.62.

e propozuar, pengesat e pronësisë janë të panevojshme dhe ai gjithashtu pretendon se “nën situatën aktuale, konkurenca efektive dhe e ndershme është shkelur rëndë, cilësia e shërbimeve audio dhe audiovizuale mund të bjerë dhe një nga parimet kryesore mbi të cilin AMA duhet të ushtrojë aktivitetin e saj, atë të garantimit të aksesit të barabartë dhe jo diskriminues të tregut audio dhe audiovizual të medias, mund të shkelet.” Heqja e këtyre kufizimeve sigurisht që do të zgjidhte dilemën e AMAs në dhënien e një numri të kufizuar licensash për aplikantët aktualë. Megjithatë, ajo do të çonte në një përqendrim të pronësisë për rrjetet dixhitale që do të licensoheshin si dhe asnjë garanci për pluralizmin e medias në të ardhmen e procesit të licensimit. Opozita e kundërshtoi hapur këtë propozim duke pretenduar se propozimi ka për qëllim që të hapi rrugën për vendosjen e monopoleve në tregun e medias. Mazhoranca dhe opozita në Komisionin Parlamentar të Medias vendosën të kërkonin ndihmën e OSBE, Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës përpara se të ndërmerren vendimin përfundimtar mbi ndryshimet e propozuara dhe një rekomandim për të votuar në seancën parlamentare. Mbetet për t’u parë se si parlamenti dhe aktorët e tjerë do ta trajtojnë këtë çështje delikate me pasoja të mëdha për pluralizmin e medias. Megjithatë rregullimi i pronësisë është një tjetër faktor që mund ta vonojë më tej procesin tashmë të stërvonuar të kalimit në dixhital.

## **- Transmetuesit lokalë në kontekstin e dixhitalizimit**

Një pjesë e rëndësishme e panoramës së medias janë gjithashtu media lokale, e cila aktualisht transmetojnë në analog, duke pasur parasysh rëndësinë në pluralizmin e medias dhe rolin që kanë ato brenda komuniteteve ku operojnë. Duke u bazuar në Strategjinë për Kalimin në Transmetime Numerike, ka tre variante për operatorët lokal, kur kalimi në dixhital është shumë pranë:

1. Brenda variantit të parë, transmetuesit lokal do të përdorin platformën e ngritur nga transmetuesi publik RTSH;
2. Variant tjetër është që operatorët lokalë të bashkohen dhe të aplikojnë për të ndërtuar një platformë të tyre, por 70% e operatorëve lokalë duhet të bien dakort me qëllim që të aplikojnë;
3. Nëse asnjë nga dy variantet e para nuk funksionon, rregullatori hap garën për ngritjen e një rrjeti që operatorët lokalë ta përdorin.

Strategjia përcakton këto tre opsione, por thekson se variante të tjera nuk përjashtohen. Në fakt një takim publik i mbajtur në fillim të qershorit 2015<sup>21</sup> nënvizon se një variant tjetër për transmetuesit lokalë mund të jetë përdorimi i rrjeteve të ndërtuar nga operatorë të tjerë komercialë, që do të thotë ato ekzistuese dhe dy televizionet kombëtare komerciale që kanë aplikuar për të marrë një licensë kombëtare për të ndërtuar një platformë.

---

<sup>21</sup> AMA takon operatorët lokale, Qershor 1, 2015.

Në këtë aspekt një faktor kryesor do të jetë tarifa e aplikuar për të përdorur rrjetin që transmetuesi publik po ndërton. Sipas Strategjisë tarifa e llogaritur në 2012 është vlerësuar të jetë 2,885 Euro në muaj për secilin operator që do të përdorë rrjetin e transmetuesit publik. Aktualisht drejtuesit e AMA pretendojnë se nuk ka transparencë të mjaftueshme tek Strategjia se si kjo tarifë është përlllogaritur dhe është paksa e lartë për operatorët lokalë. Si rezultat transmetuesi publik do ta rishikojë tarifën dhe do të paraqisë një variant të ri për ata transmetues lokalë që dëshirojnë t'i bashkëngjiten rrjetit publik. Ky episod sugjeron përsëri rëndësinë e dixhitalizimit të transmetuesit publik me qëllim për të hapur rrugën për hapin tjetër të procesit dhe të sigurojë mundësi të barabarta dhe të drejta për transmetimin dixhital nga ana e operatorëve lokalë gjithashtu.

### ***- Përgjegjësi dhe transparencë ndaj publikut***

Një element shumë i rëndësishëm që trajtohet në Strategji është çështja e aksesit dhe e mundësisë financiare për kalimin në transmetime dixhitale. Strategjia nënvizon nevojën me pajisje vecanërisht për shtresat më të varfra të popullsisë, duke vënë në dukje ndihmën nga ana e shtetit për këtë qëllim.<sup>22</sup> Gjithashtu Strategjia sugjeron përdorimin e dekoderave universalë. Në këtë kontekst Këshilli i Ministrave aprovoi më 3 qershor një vendim që

---

<sup>22</sup> Strategjia, fq.42.

ka për qëllim të rregullojë rregullat teknike në aparatet TV që do të shiten në treg, duke synuar një standard kompresimi DVB/T2/MPEG4 dhe duke përdorur një ndërfaqe të përbashkët <sup>23</sup>.

Megjithëse Strategjia nënvizon nevojën e një fushate të ndërgjegjësimit publik, nga ana e tij publiku është plotësisht i painformuar se çfarë do të thotë kalimi në transmetime dixhitale. Deri tani ky debat është kufizuar brenda rrethëve mediatike dhe publiku është gjerësisht i painformuar me procesin dhe pritshmëritë. Në fakt nuk ka pasur asnjë diskutim në media në lidhje me kalimin në dixhital. Diskutimi dhe dëgjesat parlamentare janë raportuar kryesisht nga media nga i njëjti grup sic janë platformat ekzistuese, në përputhje me interesat që secila kompani ka në lidhje me kalimin në dixhital. Megjithatë nuk ka pasur programe të zgjeruara apo diskutime të organizuara përveç raportimit në lajmeve. Ky diskutim është konsideruar më shumë si një zhvillim i brendshëm i kompanive mediatike apo i transmetuesit publik se sa një proces që do të prekë cdo qytetar. Fushata për informimin e publikut është parashikuar në Strategji dhe është gjithashtu pjesë e planit të punës së AMAs, por deri tani përgatitjet për këtë komponent nuk kanë filluar akoma.

---

<sup>23</sup> Keshilli i Ministrave Vendimi nr.480, date 3 Qershor, 2015.



## Përfundime

Procesi i kalimit në transmetime dixhitale në Shqipëri po vonohet. Ndërthurja e interesave komplekse të biznesit, dështimi i rregullatorit për të vepruar, mosmarrëveshjet ligjore dhe dixhitalizimi i ngadaltë i transmetuesit publik janë vetëm disa nga faktorët që kanë prekur progresin e kalimit në dixhital. Duke pasur parasysh dinamikat dhe interesat që mbizotërojnë në skenën e medias, ishte e pashmangshme që kalimi në dixhital t'u shpëtonte këtyre prirjeve. Megjithatë, përderisa procesi është praktikisht në fillimet e tij ka nevojë për monitorim të metejshëm se si aktorë të veçantë, institucione dhe rregullore do të prekin rezultatin përfundimtar dhe nëse procesi do të jetë i drejtë, transparent dhe do të ndjekë interesin publik.